



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 13.6.2024, merr këtë

V E N D I M
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për transferimin e mjeteve prej 150,000.00 €, nga fondi i rezervës komunale, në kategorinë e *investimeve kapitale*.

Neni 2

Sipas nenit I të këtij vendimi, duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin 2024, nr. 08/L-260, neni 15, pika 11, nga fondi i rezervës komunale, mjetet në vlerë prej 150,000.00 € orientohen në investime kapitale, respektivisht mjetet në vlerë prej 150,000.00 € orientohen në programin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në nënprogramin e Infrastrukturës publike 18166, për projektin me kodin 53589. "Ndërtimi dhe rikonstruktimi i pritoreve të autobusëve, bankave për pushimore: "Qendra", "Tophane", "Dodona", "Bregu i Diellit", "Ulpiana", "Dardania", "Lakërishta", "Kodra e Trimave", Bërnice, Kolovicë dhe "Velania".

Neni 3

Sipas nenit II të këtij vendimi, shuma e mjeteve të transferuara është 150,000.00 €.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore me detajet e hollësishme.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/03-77942/24, më 18.6.2024

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

